



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2023

**VENDIM**

**Nr. 160, datë 05.04.2023**

**PËR**

**CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

**VENDOSI:**

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KUKËS**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Aulon Pashaj dhe Ermelinda Fejzo, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria; I pandehur: {...}; Akuza: Neni 100/2, 130/a/4, 278/3/4, 280, 284/1 i Kodit Penal.

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TROPOJË**

1. Gjyqtaret e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, Suada Kurti dhe Merita Karaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë; Objekti: Kërkesë për gjykim të procedimit penal nr.488, viti 2009 në ngarkim të të pandehurit {...}; Akuza: Neni 141/a paragrafi 2 i Kodit Penal.

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR POGRADEÇ**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Seladin Pysqyli dhe Luljeta Kole, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, etj; Të pandehur: {...}, {...}; Viktimë: {...}, {...}; Akuza: “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor” e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 290/4 të Kodit Penal etj.

### **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LUSHNJË**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Sonila Hoxha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}, {...}, {...}, {...}, {...}; Akuza: “Kultivimi i bimëve narkotike” e kryer në bashkëpunim, “Vjedhje e energjisë elektrike”-neni 284/3 dhe 137/2 i Kodit Penal, etj.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Alfred Konomi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}; Akuza: Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/3 të Kodit Penal.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Sonila Hoxha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}, {...}; Akuza: “Prodhim dhe shitja e narkotikëve”, “Kultivimi i bimëve narkotike”, etj.

4. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Alfred Konomi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Person i Tretë: {...} etj; Objekti: Heqje e zotësisë për të vepruar, etj.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**